# PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

**Kapitulli 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Fitosanitetit**

**29 Korrik 2026**



**PROJEKTUDHÈZIM**

**“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA MBI PROCEDURAT QË KRYHEN GJATË DHE PAS KONTROLLEVE DOKUMENTARE, KONTROLLEVE TË IDENTITETIT DHE KONTROLLEVE FIZIKE TË KAFSHËVE DHE MALLRAVE QË I NËNSHTROHEN KONTROLLEVE ZYRTARE NË PIKAT E KONTROLLIT KUFITAR"**

**PËRAFRON PLOTÈSISHT:**

**RREGULLOREN ZBATUESE TË KOMISIONIT (BE) 2019/2130, DATË 25 NËNTOR 2019**

**NË ZBATIM TË**

**LIGJIT NR. 61/2026 "PËR KONTROLLET ZYRTARE"**

## *Udhëzim*

*“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi procedurat që kryhen gjatë dhe pas kontrolleve dokumentare, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të kafshëve dhe mallrave që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në pikat e kontrollit kufitar"*

## Qëllimi i udhëzimit

Përcakton procedurat e detajuara që zbatohen gjatë dhe pas kontrolleve zyrtare në Pikat e Kontrollit Kufitar (PKK).

Siguron zbatim të unifikuar të kontrolleve dokumentare, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike.

Forcon funksionimin e sistemit të kontrollit zyrtar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

# Udhëzimi zbatohet për procedurat e kontrollit zyrtar në Pikat e Kontrollit Kufitar (PKK) për:

1. Kafshët
2. Produktet ushqimore me origjinë shtazore
3. Produktet ushqimore te përbëra
4. Produktet germinale
5. Nënproduktet me origjinë shtazore
6. Ushqimin për kafshë
7. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera
8. Bari dhe kashta


KONTROLLET NË PKK
KONTROLL DOKUMENTACIONI
KONTROLL IDENTITETI
KONTROLL FIZIK

# KONTROLLET DOKUMENTARE

**Qëllimi:** Verifikimi i dokumentacionit që shoqëron ngarkesën përpara kryerjes së kontrolleve të tjera

**Autoriteti kompetent verifikon:**

- Certifikatat zyrtare, vërtetimet dhe dokumentet shoqëruese
- Përputhshmërinë e dokumentacionit me kërkesat ligjore
- Destinacionin dhe përdorimin e synuar të ngarkesës
- Plotësimin e saktë të Dokumentit Shëndetësor të Përbashkët të Hyrjes (DSHPH)

# KONTROLLET E IDENTITETIT

Verifikojnë që ngarkesa fizike përputhet me informacionin e dokumentacionit shoqërues.

Kontrollet përfshijnë:

- Identifikimin e kafshëve (kur është e zbatueshme);
- Përmbajtjen dhe sasinë e ngarkesës;
- Shenjat dhe kodet identifikuese;
- Mjetin e transportit;
- Integritetin e vulave të kontejnerëve ose mjeteve të transportit.

# KONTROLLET FIZIKE

Udhëzimi përcakton rregulla të detajuara për:

- kryerjen e kontrolleve fizike në përputhje me kategorinë e ngarkesës;

- shkarkimin e pjesshëm ose të plotë të ngarkesës, kur është e nevojshme për kryerjen e kontrollit;

- marrjen e mostrave dhe kryerjen e testeve laboratorike;

- hartimin e planit të monitorimit për testimet laboratorike të mallrave;

- rastet kur ngarkesat mund të vendosen në treg përpara daljes së rezultateve laboratorike, kur nuk dyshohet rrezik i menjëhershëm.

•- rregulla të detajuara për përzgjedhjen e mostrave dhe përqindjet minimale të kontrollit, sipas kategorisë së ngarkesës.

# VEPRIMET PAS PËRFUNDIMIT TË KONTROLLEVE



Pas përfundimit të kontrolleve dokumentare, të identitetit dhe fizike, autoriteti kompetent:

- mbyll dhe identifikon paketat e hapura gjatë kontrollit;
- vulos mjetet e transportit kur kërkohet dhe regjistron numrin e vulës në DSHPH;
- regjistron rezultatet e analizave laboratorike në DSHPH;
- ruan certifikatat dhe dokumentacionin shoqërues në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzim.

# SHTOJCAT

## 1

**Kontrollet fizike mbi kafshët**

1. Rregullat për kontrollin e përshtatshmërisë për transport.

2. Ekzaminimin klinik të kafshëve.

3. Marrjen e mostrave për thundrakët. Kafshët

## 2

**Kontrollet fizike mbi mallrat**

1. Verifikimin e kushteve të transportit dhe etiketimit.

2. Vlerësimin fizik dhe marrjen e mostrave.

3. Planin e monitorimit dhe testimet laboratorike.

## 3

•**Kontrollet fizike mbi bimët, produktet bimore**

•1. Rregullat për kontrollin e loteve dhe marrjen e mostrave.

•2. Skemat e mostrimit sipas standardeve fitosanitare.

•3. Kriteret për testimet laboratorike bazuar në analizën e riskut.

# FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!